



Dr. Aulent Guri është Kryeauditues në Departamentin e Auditimit të Performancës në Kontrollin e Lartë të Shtetit prej datës 03.01.2017. Në periudhën 2013-2016 ai ka punuar në Bashkinë e Tiranës në Drejtorinë e Politikave dhe Edukimit Mjedisor. Para kësaj periudhe ai është angazhuar në projekte dhe studime mjedisore në studio konsulence private.

Zoti Guri me anë të Autorizimit të Kryetarit të KLSH-së nr. 15/132 prot. datë 26.10.2020 është caktuar të ushtrojë detyrat e Drejtorit të Departamentit të Auditimit të Performancës deri në emërimin e Drejtorit të këtij Departamenti.

Zoti Guri është diplomuar në Fakultetin Histori-Filologji në vitin 2011 dhe mban gradën Doktor i Shkencave në Ekonomi dhe Zhvillim i Qëndrueshëm prej 2016. Ai ka publikuar një sërë botimesh shkencore në revista kombëtare dhe ndërkombëtare në fusha mjedisore, sociale dhe ekonomike. Krahas publikimeve, para ushtrimit të detyrës në KLSH ai ka marrë pjesë në disa konferenca, seminare dhe workshope të organizuara nga organizma dhe projekte ndërkombëtare në Bruksel, Zagreb, Bukuresht, Saragoza, Athinë, Ancona etj.

Gjatë ushtrimit të detyrës së tij në KLSH ai ka zhvilluar një "Internship" 5 mujor në Gjykatën Evropiane të Llogarive (European Court of Auditors) në Luksemburg nga datat 01.10.2018 deri më 28.02.2019 duke u angazhuar në auditimin e performancës me fokus eficiencën e energjisë. Gjatë këtij Internshipi, ai ka marrë pjesë në disa takime të organizuara midis grupit të auditimit dhe përfaqësuesve të Komisionit Evropian përgjegjës për politikën dhe shpërndarjen e fondeve për të mbështetur dhe përmirësuar përdorimin me eficiencë të energjisë në shtetet anëtare të BE-së.

Gjithashtu, ai ka marrë pjesë në konferenca, trajnime dhe seminare që kanë të bëjnë me auditimet e performancës si dhe me çështje mjedisore, energjitike në vende të ndryshme si Hollandë, Indi, Sllovaki, Luksemburg, Poloni, Serbi etj. Krahas trajnimeve z. Guri ka përfaqësuar KLSH-në në disa auditime paralele ndërkombëtare si auditimi i performancës me temë "Cilësia e Ajrit" dhe "Prokurimet Publike". Një tjetër bashkëpunim i frytshëm i z. Guri ka qenë ai me Grupin e Punës në Auditimet Mjedisore të EUROSAT, Institucionin Suprem të Auditimit të Estonisë, dhe Universitetin "Tartu" në Talin, Estoni, në krijimin dhe realizimin e "Massive Open Online Course" i cili ishte një kurs intensive "on line" me temë "Auditimi i çështjeve të ujit". Në këtë kurs morën pjesë 300 studentë, dhe 185 prej tyre nga 47 vende të botës arritën ta përfundonin me sukses dhe të pajiseshin me certifikatë nga Universiteti Tartu në Estoni.